
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data: 04.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Pajisje mobilierie për objektet arsimore” e ndare ne lote

- **Loti 1: “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm” fondi limit 174,502,047.5 (njqind e shtatedhjetë e katërmilion e pesëqind e dy mijë e dyzet e shtate pike pese) leke pa tvsh dhe 1,894,290.5 Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 04.09.2026 është 92.12 Lekë.**
- **Loti 2: “Blerje pajisje mobilerie për arredimin e klasave SmartLab” fondi: 148,347,596.4 (njqind e dyzet e tete milion e treqind e dyzet e shtate mijë e pesëqind e nentedhjetë e gjashtë pike kater) leke pa tvsh dhe 1,610,373.3 Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 04.09.2026 është 92.12 Lekë.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39150000-8
(Mobilje dhe pajisje të ndryshme).

VLERA E FONDIT LIMIT: 322,849,643.9 (treqind e njëzet e dy milion e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre pikë nëntë) lekë pa TVSH. Kjo vlerë konvertohet në 3,504,663.9 euro

**Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 04.09.2026, me kurs këmbimi 92.12 lekë.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti Kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar. Specifikimet teknike dhe perlllogaritja e fondit limit janë hartuar dhe percjelle ne OBP, nga Autoriteti Kontraktor Perfitues (Ministria e Arsimit)

Loti 1: “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 20 (njëzet) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me kualifikimet/ certifikimet si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier druri është e detyrueshme vetëm në rastin kur ofertuesit shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave.

4 (kater) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

3 (tre) Bojaxhi/Ilustrues për prodhime druri (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Kërkesa për dy Bojaxhi/Ilustrues për prodhime druri është e detyrueshme vetëm në rastin kur ofertuesit shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave.

2 (dy) saldatore (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- diplomë/dëshmi/certifikim që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Kërkesa për saldatore është e detyrueshme vetëm në rastin kur ofertuesit shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave.

2 (dy) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme.

7 (shtete) punonjës të thjeshtë/ për veprimtari ndihmëse (ngarkim- shkarkim) gjatë proceseve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës.

Punonjësit e tjerë mund të jenë me profile të ndryshme si punonjës teknik dhe staf ndihmës.

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shënim: Duke qënë se mjetet e transportit, të kërkuara në këto dokumente mund të jenë edhe me qera ose në huapërdorje, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që punonjësit “Shofer” mund të disponohen edhe me kontraktim.

Shënim: Kriteri nr.2.3.2 konsiderohet i -përmbyllur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumëtimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkohet të dëshmohet nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Punonjësit me specialitetet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Edhe pse procedura është e tipit “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm”, objektet e prokurimit nuk janë produkte standarde të gatshme, por mobilje që kërkojnë prodhim, montim dhe përshtatje sipas specifikimeve teknike të tenderit dhe të ambientit të AK përfitues. Thënë kjo këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontratë ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Ky numër punonjësish është numri minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësore, të qëndrueshme dhe jetëgjata, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektin ku do të kryhet furnizimi, vendosja/monitimi dhe kolaudimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvrimin të mallit. Pra, kërkesa për këto profile nuk është e tepruar, por proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të prokurimit, siç parashikohet në LPP dhe RRPP. Këto kërkesa janë vendosur për të krijuar bindjen se kontrata do të realizohet me sukses sipas standardeve të cilësisë dhe funksionaliteteve të kërkuara. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,

profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses. Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri synohet të arrihet:

1. Dëshmimi i kapacitetit teknik dhe profesional duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues kanë punonjës aktivë dhe me eksperiencë për të përmbushur kontratën;
2. Verifikimi i pagesës së sigurimeve shoqërore dhe tatimore duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues respektojnë detyrimet ligjore ndaj punonjësve. Kërkesë kjo e përcaktuar edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas së cilës operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
3. Parandalimi i marrjes së ofertave nga operatorë fiktivë duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që nuk kanë një aktivitet real, pjesëmarrja e të cilëve mund të rrisë nivelin e riskut për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asebloquent sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoriti Kontraktor përfitues në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtij autoriteti me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri.

Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e

cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoriteti Kontraktor përfitues në këtë procedurë prokurimi.

4 (kater) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri:

Një marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuritë e duhura në lidhje me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambjente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

3 (tre) Bojaxhi/llustrues për prodhime druri

Një bojaxhi/llustrues i prodhimeve të drurit profesionist siguron që mobiljet të kenë një përfundim të lëmuar dhe të qëndrueshëm, gjë që përmirëson dukshëm pamjen estetike të mobiljeve dhe i bën ato të përshtatshme për përdoruesit përfundimtar, vecanërisht kur mobiljet janë pjesë e ambjenteve publike. Përdorimi jo vetëm i bojës cilësore, por edhe aplikimi i duhur nga një specialist, rrit rezistencën e mobiljeve ndaj lagështisë, pluhurit, konsumimit apo faktorëve të tjerë të jashtëm dhe kjo bën të rritet qëndrueshmëria apo jetëgjatësia e tyre, duke ulur nevojën për riparime apo zëvendësime të shpeshta. Aplikimi i bojës nga një profesionist i kualifikuar ndihmon në shmangjen e defekteve si njollat, mbeturinat apo përhapje e pabarabartë e bojës, Bojaxhiu profesionist është i trajnuar për të zgjedhur bojërat që janë në përputhje me standartet e sigurisë dhe mjedisit, gjë që ndihmon në sigurimin e një mjedisi të sigurt për përdoruesit e tyre që janë punonjësit e Autoritetit Kontraktor përfitues. Kërkesa për një bojaxhi druri profesionist është një tregues i standarteve të larta të cilësisë në produktin përfundimtar.

2(dy) saldatore

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) saldatorëve nga operatorët ekonomikë që paraqiten në cilësinë e prodhuesit është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe karakteristikat teknike të artikujve objekt prokurimi. Në specifikimet teknike parashikohen disa artikuj me skelete dhe struktura metalike, për të cilat kërkohet shprehimisht procesi i saldimit. Konkretisht, për karriget e nxënësve të ciklit të ulët dhe të lartë kërkohet që i gjithë skeleti të jetë i salduar me saldim të vazhduar me argon. Gjithashtu, për karriget e mësuesve dhe karriget e zyrës përcaktohet që struktura mbajtëse prej profili çeliku të jetë e salduar me argon ose me shkarkesë elektrike. Për më tepër, në specifikime parashikohen edhe artikuj të tjerë që përmbajnë profile dhe struktura metalike, si tavolina me skelet tubolar metalik dhe shtrati i vizitës për infermierinë me skelet prej profili metalik tubolar. Duke marrë në konsideratë volumin e furnizimit prej 23,064 artikujsh, shpërndarjen e tyre në 28 shkolla dhe afatin e realizimit prej 3 muajsh, disponimi i personelit të kualifikuar për proceset e saldimit është i nevojshëm për të siguruar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik prodhues dhe realizimin në kohë të produkteve sipas kërkesave teknike. Për këtë arsye, kërkesa për minimumi 2 (dy) saldatorë konsiderohet e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, proporcionale me volumin dhe kompleksitetin e mallrave dhe e nevojshme për

realizimin e procesit të prodhimit, duke mos u aplikuar ndaj operatorëve ekonomikë që nuk paraqiten në cilësinë e prodhuesit.

Punonjësit e tjerë si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qënë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shofertët mund të diponohen edhe me kontraktim.

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontratë ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Ky numër punonjësish është minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me sipecifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave minimumi 1.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerases.

Shënim: Kriteri nr.2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Shënim: Kriteri nr.2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë duke marrë parasysh se një pjesë e mallit do të shpërndahet në vendndodhje të ndryshme për Ministrinë e Arsimit: Vendi i dorëzimit të mallit është pranë (shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm) Sipas listes bashkëlidhur DST. Kërkesa për minimumi dy mjete është vendosur në propocion me sasinë e mallit që kërkohet dhe vendodhjen e objekteve të Autoritetit Kontraktor përfitues, ku do të depozitohet malli objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001-2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023 (të përditësuar)“Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejmë te percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi;Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

1.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Certifikatë produkti/ Certifikatë Testimi/ Raport testimi, (korespondues i produktit te kerkuar) për artikujt e kërkuar si më poshtë:

- **Tavolina nxënësi cikli ulët/ cikli lartë** - produkt i certifikuar në përputhje me standartin SSH EN 1729-1: 2015 (SSH EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore SSH EN 1729-2: 2023 Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet

arsimore – Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e përditësuar.

- **Karrige nxënësi cikli ulët/ cikli lartë** - produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1: 2015 (SSH EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore SSH EN 1729-2: 2023 Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore – Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e përditësuar.
- **Karrige për mësues me tapiceri** - produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1335-1: 2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021/AC:2016), Mobilje zyre – Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet – Përcaktimi i dimensioneve ose e njëvlefshme dhe e përditësuar, SSH EN 1335-2: 2018 (Mobilje për zyra – Karrige për zyrë- Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njëvlefshme dhe e përditësuar.
- **Tavolinë nxënësi dyvendëshe për kompjuter - Arsimi i Mesëm (Tavolinë IT)** produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015 (SSH EN 1729-1:2015/AC:2019), Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore SSH EN 1729-2: 2023 Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore – Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e përditësuar.

Shënim: Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme per gjate periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në baze të nenit të 79 “Standardet e sigurimit të cilësise dhe standardet e menaxhimit mjedisor” , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 44 “Kërkesat e cilësise” VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe me autoritetin dhe kompetencën që percaktohet në këtë legjislacion *Autoriteti kontraktor kërkon nga Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike pjesëmarrës dhe konkurrues në këtë procedure dorezimin sipas artikujve që marrin persipër për furnizim, që duhet të paraqesin dokumentacion teknik certifikues i cili përfshin “Certifikate/Certifikate testimi” vetëm për një pjesë të vogël të artikujve në listë.*

Në këtë mënyrë është bërë kujdes që kërkesa për dokumentacion teknik verifikues dhe konfirmues të cilësise të mos shtrihet në të gjithë artikujt e listës duke rënduar operatorët ekonomik, ndonëse ato duhet vetë të demostrojnë reputacionin e kompanisë në drejtim të cilësise së produkteve që ofrojnë nëpërmjet posedimit të certifikatave të produkteve të cilat janë konfirmim i kalimit të testeve të caktuara në laboratore të specializuara.

AK ka kërkuar si dokument “Certifikate/Certifikate testimi” të produkteve koresponduese e standardeve të mesiperme, por operatori ekonomik mund të paraqesë Certifikata me reference

standarde ekuivalente duke bere shpjegimin dhe duke i bere te qarte operatorit se cfare perfaqeson ne kete rast ekuivalenca e vertifikatave.

Kushti eshte vendosur krejtesisht ne perputhje me procedurat profesionale duke ditur qe zanafilla e cdo dokumenti konfirmues dhe te perputhshmerise me standarde te vecanta eshte kalimi i testeve laboratorike.

Pra cdo dokument i leshuar ka baze konfirmimin ne kete rast pozitiv te rezultateve testuese laboratorike.

Asnje dokument konfirmues dhe referues ne standarde specifike nuk leshohet pa kryerjen e testeve. Ne kete rast AK vendos ne pozita te barabarta te gjithe operatoret.

Theksojme se Deklarata per respektimin e specifikimeve teknike nuk zevendeson dokumentacionin teknik sepse certifikimi lidhet me veti te fshehta te produktit qe nuk konfirmohen as evidentohen nga vzhgimi i jashtem i mallit (karakteristika te fshehta te produktit) por mund te shfaqen apo zbulohen ne cdo moment nga vete produkti apo me kalimin e kohes edhe jashte afateve te garancise.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas tabelës 1 nese eshte prodhues ose sipas tabelës 2 nese eshte **tregtues i autorizuar** nga prodhuesi ose **distributor i autorizuar nga prodhuesi** per mallrat objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si prodhues/perpunues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi
1			
2			
Etj.,			

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, AK gjykon se për çdo artikull vlerësohet realisht aktiviteti që merr persipër të realizojë operatori ekonomik pra OE respektiv do të jetë në rolin e prodhuesit apo tregëtuesit, vlerësohet origjina e produktit duke marrë një informacion edhe mbi reputacionin e prodhuesit të parë, si dhe gjykon mbi riskun që mund të ketë realizimi i kontratës nga përfshirja në realizimin e kontratës së subjekteve të tjera që në shumë raste nuk janë me aktivitet në Shqipëri.

Nderkohe subjektet ofertuese në bazë të plotësimit të tabelave të sipercituara pozicionohen në plotësimin e kërkesave të tjera që lidhen me numrin e punonjësve, profesionistët që duhet të disponojnë sipas profesioneve bazë dhe me të rëndësishme të kërkuara, ambientet e disponueshme në pronësi apo me qira etj.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1(një) vit të garancisë së mallrave, objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose të cilësia të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë** me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresat përkatëse sipas përcaktimeve në këto dokumente të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se objekti i prokurimit do të realizohet në kohë dhe cilësi dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Në vendosjen e këtij kriteri organi qendror blerës ka në vëmendje zbatimin e kontratës, në cilësinë e fazës më të rëndësishme të ciklit të prokurimit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Ministria e Arsimit, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Loti 2: “Blerje pajisje mobilerie për arredimin e klasave SmartLab”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik

dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.4 Kapaciteti teknik:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 18 (tetembedhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me kualifikimet/ certifikimet si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier druri është e detyrueshme vetëm në rastin kur ofertuesit shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave.

3 (tre) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

2 (dy) saldatore (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- diplomë/dëshmi/certifikim që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Kërkesa për saldatore është e detyrueshme vetëm në rastin kur ofertuesit shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave.

2 (dy) Bojaxhi/Ilustrues për prodhime druri (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Kërkesa për dy Bojaxhi/llustrues për prodhime druri është e detyrueshme vetëm në rastin kur ofertuesit shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave.

2 (dy) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme.

6 (gjashtë) punonjës të thjeshtë/ për veprimtari ndihmëse (ngarkim- shkarkim) gjatë proceseve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës.

Punonjësit e tjerë mund të jenë me profile të ndryshme si punonjës teknik dhe staf ndihmës.

Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shënim: Duke qënë se mjetet e transportit, të kërkuara në këto dokumente mund të jenë edhe me qera ose në huapërdorje, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që punonjësit “Shofer” mund të disponohen edhe me kontraktim.

Shënim: Kriteri nr.2.3.2 konsiderohet i -përmbyllur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumëtimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të

ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkohet të dëshmohet nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Punonjësit me specialitetet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Edhe pse procedura është e tipit “Blerje pajisje mobilierie për për arredimin e klasave SmartLab”, objektet e prokurimit nuk janë produkte standarde të gatshme, por mobilje që kërkojnë prodhim, montim dhe përshtatje sipas specifikimeve teknike të tenderit dhe të ambientit të AK përfitues. Thënë kjo këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontrate ka si proces prodhimit ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Ky numër punonjësish është numri minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësore, të qëndrueshme dhe jetëgjata, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektin ku do të kryhet furnizimi, vendosja/monitimi dhe kolaudimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvrimit të mallit. Pra, kërkesa për këto profile nuk është e tepruar, por proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të prokurimit, siç parashikohet në LPP dhe RRPP. Këto kërkesa janë vendosur për të krijuar bindjen se kontrata do të realizohet me sukses sipas standardeve të cilësisë dhe funksionaliteteve të kërkuara. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses. Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri synohet të arrihet:

1. Dëshmimi i kapacitetit teknik dhe profesional duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues kanë punonjës aktivë dhe me eksperiencë për të përmbushur kontratën;

2. Verifikimi i pagesës së sigurimeve shoqërore dhe tatimore duke treguar që operatorët ekonomikë ofertues respektojnë detyrimet ligjore ndaj punonjësve. Kërkesë kjo e përcaktuar edhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas së cilës operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
3. Parandalimi i marrjes së ofertave nga operatorë fiktivë duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që nuk kanë një aktivitet real, pjesëmarrja e të cilëve mund të rrisë nivelin e riskut për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoriti Kontraktor përfitues në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtij autoriteti me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

1(një) inxhinier druri.

Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoriteti Kontraktor përfitues në këtë procedurë prokurimi.

3 (tre) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri:

Një marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuritë e duhura në lidhje me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambiente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2 (dy) Bojaxhi/Ilustrues për prodhime druri

Një bojaxhi/lustrues i prodhimeve të drurit profesionist siguron që mobiljet të kenë një përfundim të lëmuar dhe të qëndrueshëm, gjë që përmirëson dukshëm pamjen estetike të mobiljeve dhe i bën ato të përshtatshme për përdoruesit përfundimtar, vecanërisht kur mobiljet janë pjesë e ambienteve publike. Përdorimi jo vetëm i bojës cilësore, por edhe aplikimi i duhur nga një specialist, rrit rezistencën e mobiljeve ndaj lagështisë, pluhurit, konsumimit apo faktorëve të tjerë të jashtëm dhe kjo bën të rritet qëndrueshmëria apo jetëgjatësia e tyre, duke ulur nevojën për riparime apo zëvendësime të shpeshta. Aplikimi i bojës nga një profesionist i kualifikuar ndihmon në shmangjen e defekteve si njollat, mbeturinat apo përhapje e pabarabartë e bojës, Bojaxhiu profesionist është i trajnuar për të zgjedhur bojërat që janë në përputhje me standartet e sigurisë dhe mjedisit, gjë që ndihmon në sigurimin e një mjedisi të sigurt për përdoruesit e tyre që janë punonjësit e Autoritetit Kontraktor përfitues. Kërkesa për një bojaxhi druri profesionist është një tregues i standarteve të larta të cilësisë në produktin përfundimtar.

2(dy) saldatore

*Ne lotin dy, konkretisht Saldatori është i domosdoshëm sepse: Në specifikimet teknike të Lotit 2 parashikohet furnizimi me karrige rrotulluese me krah mbështetës dhe tavolina, të cilat përmbajnë elementë dhe konstruksione metalike. Konkretisht, karriget kanë bazament metalik në formë ylli me 5 degë, si dhe pjesë metalike që lidhen me mekanizmin e ulje-ngritjes dhe strukturën e karriges. Gjithashtu, tavolinat mbështeten mbi 4 këmbë metalike prej alumini, me seksion rrethor Ø50 mm dhe trashësi jo më të vogël se 1.5 mm, të cilat kërkojnë përpunim dhe montim të elementeve metalike. Duke marrë në konsideratë volumin e konsiderueshëm të furnizimit, prej 20,687 artikujsh, si dhe kërkesën për realizimin e furnizimit brenda afatit të përcaktuar, disponimi i personelit të kualifikuar për punimet metalike është i nevojshëm për sigurimin e kapacitetit teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik prodhues. Kërkesa për 2 (dy) saldatorë konsiderohet proporcionale me objektin dhe volumin e kontratës, pasi synon të garantojë kapacitetin minimal njerëzor të nevojshëm për proceset e përpunimit dhe montimit të elementeve metalike gjatë prodhimit, pa vendosur një kërkesë të tepërt ndaj operatorëve ekonomikë. Kjo kërkesë zbatohet **vetëm për operatorët ekonomikë që paraqiten në cilësinë e prodhuesit**, pasi për operatorët ekonomikë që furnizojnë mallra të prodhuara nga të tretë, proceset e prodhimit dhe përpunimit metalik nuk kryhen prej tyre.*

Punonjësit e tjerë si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qenë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shofertët mund të diponohen edhe me kontraktim.

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontratë ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Ky numër punonjësish është minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave minimumi 1.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerase.

Shënim: Kriteri nr.2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Shënim: Kriteri nr.2.3.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë duke marrë parasysh se një pjesë e mallit do të shpërndahet në vendndodhje të ndryshme për Ministrinë e Arsimit: Vendi i dorëzimit të mallit është pranë (shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm) Sipas listes bashkëlidhur DST. Kërkesa për minimumi dy mjete është vendosur në propocion me sasinë e mallit që kërkohet dhe vendodhjen e objekteve të Autoritetit Kontraktor përfitues, ku do të depozitohet malli objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001-2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023 (të përditësuar) “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i

vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimin të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Certifikatë produkti/ Certifikatë Testimi/ Raport testimi, korespondues i produktit të kerkuar me për artikujt e kerkuar si më poshtë:

- **Tavolinë** -produkt i certifikuar në përputhje me standartin SSH EN 1729-1:2015 (SSH EN 1729-1:2015/AC:2019), Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore SSH EN 1729-2: 2023 Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore – Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e përditësuar.
- **Karrige rrotulluese me krah mbështetës** - produkt i certifikuar në përputhje me standartin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, Mobilje zyre – Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet – Përcaktimi i dimensioneve ose e njëvlefshme dhe e përditësuar, SSH EN 1335-2: 2018 (Mobilje për zyra – Karrige për zyrë- Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose SSH

EN 16139:2025 Mobilje - Siguria, rezistenca dhe qëndrueshmëria – Kërkesat dhe metodat e provave për ndenjës jo-shtëpiake e njëvlefshme dhe e përditësuar.

Shënim: Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme per gjate periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me originalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 79 “Standardet e sigurimit të cilësise dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” e ndryshuar dhe nenit 44 “Kërkesat e cilësise” VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe me autoritetin dhe kompetencën që përcaktohet në këtë legjislacion *Autoriteti kontraktor kerkon nga Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike pjesemarrës dhe konkurrues në këtë procedure dorezimit sipas artikujve që marrin pjesë për furnizim, që duhet të paraqesin dokumentacion teknik certifikues i cili përfshin “Certifikate/Certifikate testimi” vetëm për një pjesë të vogël të artikujve në listë.*

Në këtë mënyrë është bërë kujdes që kërkesa për dokumentacion teknik verifikues dhe konfirmues të cilësise të mos shtrihet në të gjithë artikujt e listës duke rënduar operatorët ekonomik, ndonëse ato duhet vetë të demonstronjë reputacionin e kompanisë në drejtim të cilësise së produkteve që ofrojnë nëpërmjet posedimit të certifikatave të produkteve të cilat janë konfirmim i kalimit të testeve të caktuara në laboratore të specializuara.

AK ka kërkuar si dokument “Certifikate/Certifikate testimi” të produkteve koresponduese e standardeve të mesiperme, por operatori ekonomik mund të paraqesë Certifikata me reference standarde ekuivalente duke bërë shpjegimin dhe duke i bërë të qartë operatorit se çfarë përfaqëson në këtë rast ekuivalenca e vertifikatave.

Kushti është vendosur krejtësisht në përputhje me procedurat profesionale duke ditur që zanafilla e çdo dokumenti konfirmues dhe të përputhshmerisë me standarde të vecanta është kalimi i testeve laboratorike.

Për çdo dokument i leshuar ka bazë konfirmimin në këtë rast pozitiv të rezultateve testuese laboratorike.

Asnjë dokument konfirmues dhe referues në standarde specifike nuk leshohet pa kryerjen e testeve. Në këtë rast AK vendos në pozita të barabarta të gjithë operatorët.

Thëksojmë se Deklarata për respektimin e specifikimeve teknike nuk zëvendëson dokumentacionin teknik sepse certifikimi lidhet me veti të fshehta të produktit që nuk konfirmohen as evidentohen nga vëzhgimi i jashtëm i mallit (karakteristika të fshehta të produktit) por mund të

shfaqen apo zbulohen ne cdo moment nga vete produkti apo me kalimin e kohes edhe jashte afateve te garancise.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te deklarroje sipas tabelës 1 nese eshte prodhues ose sipas tabelës 2 nese eshte **tregtues i autorizuar** nga prodhuesi ose **distributor i autorizuar nga prodhuesi** per mallrat objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si prodhues/perpunues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi
1			
2			
Etj.,			

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, AK gjykon se per cdo artikull vleresohet realisht aktiviteti qe merr persiper te realizoje operatorin ekonomik pra OE respektiv do te jete ne rolin e prodhuesit apo tregtuesit, vleresohet origjina e produktit duke marre nje informacion edhe mbi reputacionin e prodhuesit te pare, si dhe gjykon mbi riskun qe mund te kete realizimi i kontrates nga perfshirja ne realizimin e kontrates e subjekteve te tjera qe ne shume raste nuk jane me aktivitet ne Shqiperi.

Nderkohe subjektet ofertuese ne baze te plotesimit te tabelave te sipercituara pozicionohen ne plotesimin e kerkesave te tjera qe lidhen me numrin e punonjesve, profesionistet qe duhet te disponojne sipas profesioneve baze dhe me te rendesishme te kerkuara, ambjentet e disponueshme ne pronesi apo me qira etj.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1(një) vit të garancisë së mallrave, objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose të cilësia të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë** me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresat përkatëse sipas përcaktimeve në këto dokumente të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se objekti i prokurimit do të realizohet në kohë dhe cilësi dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Në vendosjen e këtij kriteri organi qendror blerës ka në vëmendje zbatimin e kontratës, në cilësinë e fazës më të rëndësishme të ciklit të prokurimit.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike,

financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Ministria e Arsimit, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.